REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 20835
Nr. i faq. Br. str. 6 Data: Datum: 28/06
KAMENICË/A 2024

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E KAMENICËS**
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

---

**Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor në fshatin Roganë**

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

**Publikimet:**

**UEBFAQE:**

**FACEBOOK:**

https://ëëë.facebook.com/photo?fbid=878912590937741&set=pcb.878912930937707

**PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:**

**Me 27.06.2024** dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Hodonoc duke filluar nga ora **20:00.**

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Kryesuesi I Kuvendit Komunal, Liridon Kastrati, Shefi I Kabinetit te Kryetarit ,Vaxhid Rexhepaj, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqsin te ndaj me juve detajet kryesore te buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veqant sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shum të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojm një draft buxhet për vitin e ardhshëm.  Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro, ku pjesa

e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres qe përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju I konsideroni më të rëndësishmë në fshatin Roganë.

Më pasë Shefi I Kabineti të Kryetarit, Vaxhid Rexhepaj ka prezantuar punët që janë bërë vitin e kaluar: Secili nga ju qe jeton ne Rogan e dini se qka eshte punuar dhe qka duhet investuar në fshatin e juaj, jan edhe disa rrug ne process per vitin 2024, ajo qka kemi bere eshte edhe ndarja e grandeve per start up qe janë 11 përfitues. Ka filluar edhe projekti per ujrat atmosferik, ju inkuroj edhe ju qe te beni pjesë sepse me kerkesat e juaja ne kemi me te let ti zgjidhim problemet qe i keni ne infrastruktur ne fshatin e juaj. Vetëm në këtë mënyr e këmi më të leht dhe më të shpejt zgjidhjen e problemeve. Secili nga ju qe keni kerkesa te bi beni dhe ne me mundesi do ti trajtojm.

**Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:**

Banori Satmifer Kryeziu: Une e di qe egziston kshilli lokal ne fshatin rogan, dhe deshirojm se cilat projekte i ka future kryetari I kshillit Lokal në listë dhe cialt projekte nuk janë future, që ne të kem më të qartë dhe më të leht në kërkesat tona

Kryetari i Këshillit Lokal, Jeton Kryeziu: ujësjellësi në rogan, Ndriqimi publik në rruga e "Dijes" dhe "Kamer Thaqi", rregullimi i trotuarit përgjat rruges Selver Kryeziu me mundësi zgjermi, zgjerimi I disa urave, asfaltimi i disa rrugicave- degzimeve ne Novosell, hapja dhe asfaltimi që është degezim i rruges selver kryeziu. Vendosja e disa shtyllave tek rruga Selver Kryeziu, rregullimi i një parku publik, Mbjellja e disa drunjëve dekorativ, Kanalizimi ne rrugen e novoselles. Keto kerkesa jan ardhe nga vet banoret, dhe normalisht që plotësohet edhe me ndihmen e juaj që jeni ktu prezent.

Banori Zijadin Thaqi : Une e kam nje propozim konkret, e kemi shtepin e Hoxhes qe eshte shtepi e vjeter, afer kafiteris Pronto, qe komuna me bashkesin islame te ndertojn nje park. Qështja e Ures tek Depo te Besiani, gjitheher kemi has në probleme. Shtrimi i rruges ne degzimin e rruges Selver Kryeziu.

Banori Burim Kryeziu: Tri ura jan me urgjente, Sabit Rudhani, Ramadan Kallaba dhe Hafiz Kallaba, krijon nje rrezikshmeri te lart, të rregullohet gjithashtu edhe shtrati i lumit. Une kam kerkes edhe nga shkolla qe te ndertohet nje park per femije tek shkolla.

Banori Rudhani: kam një kërkes personale, kërkesa ime është që te asfaltohet rruga me gjatesi 40m, ne jemi dy familje që jetojmë aty, por në të ardhmen ka mundësi që të shtohen familjet.

Banori Besnik Rudhani: Unë qka kish menduar që të punoj komuna në rastin e planifikimit te buxhetit, jo ndoshta me u fokusuar gjdo herë te investimet kapitale, por është pjesa e subvencioneve sidomos në bujqësi dhe biznese, unë jam dëshmitarë që dy vite aplikoj për grantet për biznes dhe StratUP, aty ka disa mangësi të vogla, është mirë që kriteret e dhënjes të jenë më të përforcuara, kisha sugjeruar që të rriten më shum për vitin 2025. Ndërsa si investime

kapitale që u përmend për vitin e kaluar ka qenë qështja e qerdhes ku janë proceduar dhe deri ku kan mrri punimet e rruges për tek stadionit te atletikes?

Vaxhid Rexhepaj: Problemi ku flasim Besnik është nje procedur ku është duke u zhvillu në vler prej 128,000.00 euro, në bujqësi është shumfishu shuma në subvencionim, për kto tri vite, në grante këtë vitë është ngrit subvencionimi nga viti I kaluar diku rreth 15,000.00 euro më shumë sa ishin vitin e kalur 100,000.00 euro. Sa i përket qerdhes ne veq e kemi një projekt ku është përcaktuar edhe lokacioni se ku do të ndërtohet qerdhja, ndërsa sa I përket stadonit të atletikës, është nënshkruar marrveshja më Ministrin për Kultur , Rini dhe Sport, gjithashtu është kryer marveshja edhe në infastruktur për asfaltimin, është kry edhe qështja e pagesës.

Banori Besnik: Është bërë kërkes për më shum se 20vjet për rregullimin e rrugës për te "Ara e Osmonit" ku mbahet takimi i vendlindjes, qdo herë që del ngarkuesi i komunes e rregullun po ajo rrug nuk është e qëndrueshme dhe prisht nga rreshjet e shiu, ajo qka kërkoj ëshë që të rregullohet rruga per një afat më të gjatë , të shttrohet asfalt si dhe në disa vende duhet të rregullohet edhe qështja e ujit atmosferik ose të vendosen gypa që të jetë më e qëndrueshme për qytetarët që shkojn në atë pjesë.

Banori Satmifer: qdo projket që po realizohet po realizohet me nguti dhe pastaj dalin disa problem tjera, si shpërndarja e ujesjellësit se po dëmtohet pjesa e asfaltume e rrugeve.

Banori Rejan Kryeziu: në lidhje me ujrat atmosferike, qe kyqi ku bëhet lidhja e urës ,kërkohet që të bëhet një devijim, për shkak të rrezikshmëris se vërshimeve.

Banori Ibrahim Kryeziu: Lumi që lidhet në mes Katushinces dhe Hodonoc, me reshjet më të vogla del nga shtarti, dhe afër lumit ka shtëpi banimi. Të shqyrtohet mundesia e rregullimit të shtarit ose pastrimit të lumit për vitin e ardhshëm. Sa i perket granteve deh buvencioneve të them të drejten jam pak I shqetësuar sepse si herën e parë dhe herën e dyte nuk na kan përfshi në grant.

| | Propozuesi | Propozimi | Formë e Kontaktit |
|---|---|---|---|
| 1. | Jeton Kryeziu | Ujësjellësi në rogan,<br>Ndriqimi publik në rruga e "Dijes" dhe "Kamer Thaqi",<br>Rregullimi i trotuarit përgjat rruges Selver Kryeziu me mundësi zgjermi,<br>Zgjerimi I disa urave, asfaltimi i disa rrugicave- degzimeve ne Novosell,<br>Vendosja e disa shtyllave tek rruga Selver Kryeziu,<br>Rregullimi i një parku publik,<br>Mbjellja e disa drunjëve dekorativ,<br>Kanalizimi në rrugen e novoselles. | Me telefon |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2. | Zijadin Thaqi | Nërtimin e një parku, tek "Shtëpia e Hoxhës",<br>Regullimi u Urës afër Depos te Besiani,<br>Asfaltimi i rrugës –degëzim I rrugës "Selver Kryeziu" | Me telefon |
| 3. | Burim Kryeziu | Regullimi urës "Sabit Rudhani",<br>Regullimi i urës"Ramadan Kallaba"<br>Regullimi i urës "Hafiz Kallaba"<br>Ndërtimi I një parku për fëmijë tek shkolla. | Me telefon |
| 4. | Banori | Asfaltimi i rrugës në gjatësi 40m | Me telefon |
| 5. | Besnik Rudhani | Kriteret në Subvendcione dhe Grante komunale të forcohen, dhe të rritet shuma për subvencionim.<br>Regullimi i rrugës, dhe Ujrave atmosferit te "Ara e Osmonit" | Me telefon |
| 6. | Rejan Kryeziu | Regullimi I ujrave atmosferik | Me telefon |
| 7. | Ibrahim Kryeziu | Regullimi i dhe pastrami i lumit që kalon në mes të Katushnicës dhe Fsh.Hodonoc. | Me telefon |

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 20:45.

Procesmbajtëse:
Samire Krasniqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në fshatin Roganë**
**Data: 27.06.2024**
**Ora: 20:00**

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Numri i telefonit | Email adresa | Gjinia | Përkatësia etnike | Nënshkrimi[1,2] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Ibrahim Kryeziu | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 2. | SATYIFER KRYEZIU | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 3. | Sylejman Kallaba | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 4. | REJAN KRYEZIU | | | M | Shqiptar | [signature] |
| 5. | SELMON -KRYE | | | M | Shqiptar | [signature] |
| 6. | Adonis Rrudhani | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 7. | Dion Rrudhan | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 8. | Ali Kryeziu | | | M | shqiptar | [signature] |
| 9. | Rinon Rrudhani | | | M | Shqiptar | [signature] |
| 10. | BEKIM KRYEZIU | | | M | SHQI | [signature] |
| 11. | ERMAL KRYEZIU | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 12. | Shefqet Rrudhan | | | M | SH qiptar | [signature] |
| 13. | Rexhep Arifi | | | M | Shqiptar | [signature] |
| 14. | Gazmend Ka | | | M | | [signature] |
| 15. | LULZIM KRYEZIU | | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 16. | Besnik Rrudhani | | | M | Shqiptar | [signature] |

[1] **SHQ**: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB**: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

[2] **SHQ:** Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunoj të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Numri i telefonit | Email adresa | Gjinia | Përkatësia etnike | Nënshkrimi[1,2] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17. | Bejtulla Rrudhi. | | | M | Shqiptar | |
| 18. | ZIJADIN THAQI. | | | M | Shqiptar | |
| 19. | Samet Kryeziu | | | M | Shqiptar | |
| 20. | Admirim Kryeziu | | | M | Shqiptar | |
| 21. | Egzon Kryez | | | M | Shqiptarë | |
| 22 | Bujar Kollok | | | M | -//- | |
| 23 | Ramadan I Krye | | | M | -//- | |
| 24 | | | | | | |
| 25 | | | | | | |
| 26 | | | | | | |
| 27 | | | | | | |
| 28 | | | | | | |
| 29 | | | | | | |
| 30 | | | | | | |
| 31 | | | | | | |
| 32 | | | | | | |
| 33 | | | | | | |
| 34 | | | | | | |
| 35 | | | | | | |
| 36 | | | | | | |
| 37 | | | | | | |
| 38 | | | | | | |
| 39 | | | | | | |

[1] **SHQ**: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB**: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

[2] **SHQ:** Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përdorë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.